

VENDIM
Nr.1271, datë 17.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1034, DATË 9.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KRYERJEN E
TRANSPLANTIT TË VESHKËS, PËR DISA SHTETAS, NË ANKARA, TURQI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, që, me fondin 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë, të kryejë transplantin e veshkës, për disa shtetas, përmes shoqërisë “Enar Saglik ve Egitim Hiz.Ltd”. ”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të negociojë dhe të lidhë kontratën me shoqërinë “Enar Saglik ve Egitim Hiz.Ltd”, në Ankara, Turqi, për kryerjen e transplantit të veshkës, pranë qendrës spitalore “Ibni Sina Hastanesi Sihhiye” ose në qendrat spitalore, të autorizuar dhe nën përgjegjësinë e kësaj shoqërie, të licencuara për ofrimin e këtij shërbimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha